



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9761 Prot.

Roskovec, më 01, 11 2022

VENDIM

NR 84 .DATË 31.10 .2022

“PËR PËRDITËSIM NË LISTËN E INVENTARIT ,MIRATUAR ME VKM-NË NR.108,DATË 17.02.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KURJAN, BASHKIA ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k) ; Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) ; Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Përditësimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kurjan ,Bashkia Roskovec të miratuar me VKM-në nr.108 datë 17.02.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Komunës Kurjan** , Qarku Fier" këtij inventari do ti shtohet prona me nr.213 zk 3805 fshati Vlosh,Njësia Administrative Kurjan.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur këtij vendimi:

- Planvendosja për pronën
- Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore

